




REPUBLIKA E KOSOVES AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK Nr. i faq. Broj stranica 04 Nr. pages	Nr Prot Br Prot 01-2512/14 Prot No Data Datum 04-07-2014 Date PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Dukagjin RAMADANI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Pronës
CC:	z. Marian NIEORA Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare të Pronës z. Xhevat AZEMI zv. Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Pronës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Sigurimi i objekteve të AKP-së me roje fizike dhe Mirëmbajtja e sistemit të alarmimit "

I nderuari z. RAMADANI ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Sigurimi i objekteve të AKP-së me roje fizike dhe Mirëmbajtja e sistemit të alarmimit " ri-tender, me nr. të prokurimit: R-329-13-32-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Sigurimi i objekteve të AKP-së me roje fizike dhe Mirëmbajtja e sistemit të alarmimit " ri-tender, me nr. të prokurimit: R-329-13-32-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit pranë Agjencisë Kosovare të Pronës ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "Sigurimi i objekteve të AKP-së me roje fizike dhe Mirëmbajtja e sistemit të alarmimit" (ri-tender), me nr. të prokurimit: R-329-13-32-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.17.06.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka ekzaminuar dhe krahasuar me kujdes dokumentet e tenderit, ka hasur në disa të dhëna të cilat bien ndesh me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit konstatoi faktet si në vijim:

Në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, tek rubrika Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika.8 Autoriteti kontraktues AKP ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar të tenderojnë që të bashkëngjisin, **Pasqyrat financiare të auditimit për vitet 2011 dhe 2012**. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se është në kundërshtim me Udhëzimin administrativ të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) nr.02/2014.

Sipas Udhëzimit administrativ të lartcekur, një Autoritet kontraktues mundet të kërkojë dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues nuk i lejohet të kërkojë qarkullim financiar vetëm për vitet 2011-2012 pa i kërkuar të njëjtat në tri vitet e fundit. **Kufizimi i qarkullimit financiar në 2 vite, e kufizon apo e zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik, prandaj konsiderohet shkelje e nenit 7 e LPP-së.**

Tek rubrika e Kapacitetit teknik ose profesional pika 10 nën pika a) janë kërkuar kontrata të vlefshme të punësimit për 50 rojtarë, b) Lista e Administratës Tatimore për tre mujorin e parë TM-1 të vitit 2014 për 50 rojtarë sipas pikës a), për tatimet e paguara (kopjet) c) Licencat e vlefshme individuale, të lëshuara nga Organi Kompetent për 50 rojtarë sipas pikës a. Për këto kërkesa të vendosura nga Autoriteti kontraktues, Agjencia konsideron se këto kërkesa eliminojnë konkurrencën e lirë dhe mund të favorizojnë Operatorë të caktuar ekonomik. Në këtë kontratë, Autoriteti kontraktues parashihet të angazhojë një numër shumë më të vogël të rojeve dhe kërkesa e vendosur ku kërkohen 50 rojtar është e panevojshme dhe diskriminuese.

Tek pika 13 e rubrikës Kapaciteti teknik ose profesional pika a dhe b janë kërkuar një (1) referencë, për ofrimin e shërbimeve të rojës fizike nga institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare, ndërmarrje publike etj që dokumenton se Operatori Ekonomik ka ofruar me shërbime të rojës fizike në **njërin nga 5 rajonet e Republikës së Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan)** si dhe ka kërkuar një (1) referencë, për furnizimin dhe Instalim me pajisje të sistemit të alarmimit (*kundër zjarrit, vjedhjes, monitorimit CCTV etj*), nga institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare, ndërmarrje publike etj, që dokumenton se Operatori Ekonomik ka kryer me furnizime dhe instalime të njëjta në **njërin nga 5 rajonet e Republikës së Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan)**.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga Autoriteti kontraktues është diskriminuese dhe nuk u mundëson Operatorëve tjerë të cilët kanë referenca për kryerjen e shërbimeve të tilla jashtë këtyre rajoneve të ofertojnë. Duke caktuar një kufizim të tillë territorial Autoriteti kontraktues favorizon vetëm Operatorët ekonomik të cilët kanë referenca në këto 5 rajone dhe në këtë mënyrë i eliminon operatorët tjerë të cilët kanë referenca në qytetet tjera të Kosovës. Duke caktuar një kërkesë të tillë Autoriteti kontraktues ka bërë diskriminim territorial në kundërshtim me LPP-në ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik “.

Agjencia lidhur me këtë pikë, gjithashtu konstaton se Autoriteti kontraktues ka kërkuar për secilën kërkesë nga një referencë pa i kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit. Autoriteti kontraktues mundet të kërkojë një listë që specifikon parimet relevante të performancës, shërbimet e përfshira, shumë e kontratës, datën. Nëse autoriteti kontraktues përcaktohet të kërkojë referenca të tilla mund të kërkojë vlera minimale të kontratave me referenca në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit, por nuk lejohet që të kërkohen kontrata dhe referenca pa i kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit.

Tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës, Agjencia vëren se Autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratë ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriteret i ka caktuar : **1. Çmimi më i Lirë**, për Shërbimet e Sigurimit me Roje Fizike të cilit i ka caktuar peshën prej **75%**, nën kriteri **2. Distanca e Qendrës Monitoruese (vjedhje, zjarr, CCTV) e OE**, nga Selia kryesore e AKP-së, pikët do ndahen si më poshtë;

Distanca nga **0 km** e deri në **25 km**, nga Selia kryesore e AKP-së është peshuar me 10%, Distanca **mbi 25 km**, nga Selia kryesore e AKP-së është peshuar me 5%, Për pikët a dhe b, të bashkëngjitet letër konfirmimi nga OE në lidhje me distancën. Lidhur me nën kriterin 2 AKK konsideron gjithashtu se është diskriminues, Autoriteti duke caktuar një nën kriter të tillë nuk i trajton në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorët ekonomik dhe se vetëm OE të cilët janë më afër se 25 km kanë mundësinë të marrin maksimumin e pikëve.

Tek nën kriteri **3** është kërkuar Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Rojeve (*Guard Tour System*), të bashkëngjitet letra e konfirmimit nga OE në lidhje me posedimin e kësaj pajisje të cilës i është

caktuar pesha **5%**, A.K duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas ligjeve në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kritere për dhënien e Kontratës, andaj konsiderojmë se ky kriter i vendosur nuk është kriter i matshëm dhe do duhej të caktohej si kriter minimal për kualifikim. Gjithashtu nën kriteri 4. Mirëmbajtja e sistemeve të sigurisë (*Alarmimit*), pjesët rezervë dhe instalimi është peshuar me **5%** nuk është kriter i matshëm.

Autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kritere të qarta, precize dhe të cilat janë kritere të matshme.

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së tenderit, tek Specifikimet teknike konstaton se njësia e kërkuese i ka propozuar gjithashtu edhe kritere të përzgjedhjes e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Me Legjislacionin e Prokurimit Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës përcaktohen qartë funksionet e njësisë së kërkesës dhe funksionet e Njësisë së Prokurimit, andaj se cila duhet veprjë konform funksioneve dhe përgjegjësive që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura si më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, me nenin 9 Funksionet e Njësisë së Kërkesës, me nenin 23 dhe nenin 25 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe me nenin 5 Gjendja ekonomike dhe financiare e Udhëzimit administrativ nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !